

## Bachelor i Ri

### në "DIZAJN INTERIERI DHE INXHINIERI DRURI"

#### Program Bachelor në " Dizajn Interieri dhe Inxhinieri Druri "

Programi Bachelor në " **Dizajn Interieri dhe Inxhinieri Druri** " kombinon aspektet shkencore, praktike dhe krijuese të përpunimit të drurit dhe materialeve me bazë druri me dizajnin artistik dhe funksional të hapësirave të brendshme. Kurikula u ofron studentëve aftësitë teknike dhe njohuritë e nevojshme për të punuar në industrinë e drurit, përveç ofrimit të njohurive në parimet e dizajnit të brendshëm.

Studentët do të marrin njohuri për materialet e drurit dhe teknikat moderne të prodhimit, së bashku me parimet e dizajnit, planifikimin hapësinor dhe dizajnin e interierit. Programi përfshin si kurse teorike ashtu edhe projekte praktike, duke u lejuar studentëve të punojnë me drurin si material për dizenjimin e mobiljeve, strukturave dhe ambienteve të brendshme. Të diplomuarit përgatiten për të zhvilluar karrieren e tyre në industrinë e përpunimit të drurit dhe dizajnit të interierit. Natyra ndërdisiplinore e programit nxit inovacionin, zgjidhjen e problemeve teknike dhe organizative duke I dhënë rëndësi përdorimit të materialeve eco-friendly dhe ndikimeve mjedisore.

#### Objektivat e Programit

Ky program ka për qëllim:

- **Zhvillimin e ekspertizës teknike për materialet drusore dhe përpunimin e tyre:** Ti pajisë studentët me njohuri të thelluara mbi vetitë e drurit, teknologjinë e përpunimit dhe metodat moderne të prodhimit për të krijuar produkte druri të qëndrueshme dhe me cilësi të lartë.
- **Nxitjen e krijimtarisë dhe inovacionit në dizajnin e interierit:** Të ofrojë aftësi për të dizenuar hapësira të brendshme që janë estetike dhe funksionale, duke integruar elemente si mobiljet, ndriçimin, ngjyrat, stilin me fokus në nevojat dhe komoditetin e përdoruesve.
- **Promovimin e praktikave të qëndrueshme në dizajn dhe aplikim:** Të inkurajojë zgjedhjen dhe përdorimin e materialeve qëndrueshme, parimet e dizajnit ekologjik dhe ndikimin mjedisor të produkteve të drurit dhe produkteve të tjera të rinovueshme.
- **Krijimin e aftësive të zgjidhjes së problemeve dhe menaxhimit të projekteve:** Të përgatisë studentët për të menaxhuar projekte dizajni dhe prodhimi, nga konceptimi deri

në ekzekutimin, duke siguruar planifikim, buxhetim dhe koordinim efektiv me palët e interesit.

- **Kultivimin e bashkëpunimit ndërdisiplinor:** Të zhvillojë aftësitë ndërdisiplinore të studentëve, duke kombinuar aspektet teknike të teknologjisë së drurit me ato artistike dhe funksionale

## Kompetencat Kryesore

Të diplomuarit do të fitojnë ekspertizë në:

- **Teknologjitë e përpunimit të drurit:** Aftësi në teknikat e përpunimit të drurit dhe teknologjitë inovative, duke përfshirë CAD dhe CNC.
- **Dizajnin dhe krijimtarinë estetike:** Përvetësimi i parimeve të dizajnit për të krijuar hapësira të brendshme vizualisht tërheqëse dhe funksionale.
- **Njohjen e materialeve me bazë druri:** Kuptimi i vetive të drurit dhe materialeve me bazë druri, burimeve të qëndrueshme dhe praktikave të dizajnit ekologjik.
- **Menaxhimin e projekteve dhe punën në ekip:** Aftësi në menaxhimin e projekteve të dizajnit, planifikimin, buxhetimin, prodhimin dhe punën efektive në ekip.

## Mundësitë e punësimit dhe karrierës

- **Inxhinier në fabrikat e industrisë së drurit**

Nëpeërmjet njohurive mbi vetitë e materialeve me bazë druri dhe teknologjinë e prodhimit të tyre, janë të aftë për të menaxhuar prodhimin dhe zbatuar teknologjitë bashkëkohore në proceset teknologjike të prodhimit të mobiljeve dhe produkteve të tjera me bazë druri.

- **Studio Arkitekture (dizajni i ndërtesave):**

Specialistët e mobiljeve dhe dizajnit të interiorit mund të jenë pjesë e studiove të arkitekturës duke kontribuar në dizajnin e ndërtesave, si dhe të ofrojnë dizajnin e mobiljeve dhe organizimin e interiorit.

- **Studio të Dizajnit të interiorit**

Specialistët e dizajnit të mobiljeve dhe interiorit mund të punësohen në studio dizajni të interiorit. Ata kanë njohuri të thella për materialet, cilësinë e tyre, fushat e përdorimit dhe teknologjitë e avancuara të përpunimit dhe prodhimit.

- **Qëndrat e Shitjes së Mobiljeve**

Specialistët e dizajnit të mobiljeve dhe interiorit mund të punojnë në qendra të mëdha shitjesh mobiljesh në vend. Kanë njohuritë e duhura për produktet dhe mund ti reklamojnë ato me kompetencë tek klientët.

- **Specialist i Pavarur në Dizajnin e Mobiljeve dhe interiorit:**

Bizneset e prodhimit të mobiljeve mund të punësojnë dizajnerë të pavarur. Ata ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë estetike të produkteve për të mbetur konkurrues në treg

## Struktura e Kurikulës

Programi trevjeçar kombinon shkencat natyrore, shkencat teknike dhe shkencat ekonomike-shoqërore:

- **Viti i Parë:** Module themelore në fizikë, matematikë, biologjia e drurit, mbrojtja e drurit, procese inxhinierike 1, bazat e ekonomisë etj. (60 ECTS).
- **Viti i Dytë:** Trajnim i avancuar në procese inxhinierike 2, Struktura dhe fizika e materialeve, teknologjia e përpunimit , përpunimi primar i drurit, prodhimi i mobiljeve , Bazat e projektimit të interiorit, Tregjet e marketingu i produkteve drusore,etj (60 ECTS).
- **Viti i Tretë:** Dy specializime në **“Inxhinierinë e Teknologjisë së Drurit”** dhe **“Dizajnin e Mobiljeve dhe interiorit”** (60 ECTS).

## Qasja Ndërdisciplinare

Në përputhje me standardet ndërkombëtare (Muster Curricula), programi balancon:

- Shkencat Natyrore (42 ECTS): Disipline baze 1, disipline baze 2, fizikë e aplikuar, biologji druri, etj.
- Shkencat Teknike (42 ECTS): Teknologji druri 2, përpunimi primar i drurit, përpunim druri me CNC, prodhim mobiljesh, etj.
- Shkencat Sociale (42 ECTS): Bazat e ekonomisë, proceset e sistemet e punës , politikat dhe ligjet, menaxhim prodhimi, etj

## Pse të Zgjidhni këtë Program?

Kjo diplomë kombinon aftësitë teknike dhe krijuese, duke i përgatitur studentët për një industri druri në rritje të fokusuar drejt zgjidhjeve ekologjike. Përmes përvojës praktike, studentët përmirësojnë aftësitë e tyre në dizajnimin dhe përpunimin e drurit , duke hapur kështu rrugë të ndryshme karriere si dizajner i interiorit dhe inxhinier i përpunimit të drurit. Ky program është ideal për ata që kërkojnë të bashkojnë talentin artistik e krijues me aplikimet në teknologjitë inovative, duke lënë gjurmë të rëndësishme në përmirësimin e cilësisë së jetës.

## KURRIKULA E STUDIMEVE

### PROGRAMI I STUDIMEVE CIKLI I PARË (BACHELOR) NË

#### **“Dizajni i interiorit dhe Inxhinieria e drurit”**

#### **Viti i Parë - 60 ECTS**

| No. | Module të detyrueshme                                      | ECTS | Lëndët                                                     |     | ECTS |
|-----|------------------------------------------------------------|------|------------------------------------------------------------|-----|------|
| 1   | Zinxhiri i vlerës së drurit dhe materialeve të rinovueshme | 6    | Zinxhiri i vlerës së drurit dhe materialeve të rinovueshme | L   | 6    |
| 2   | Disiplina bazë 1                                           | 6    | Botanikë e përgjithshme                                    | L   | 2    |
|     |                                                            |      | Njohuri per pyllin                                         | L/S | 4    |
| 3   | Disiplina bazë 2                                           | 6    | Matematikë                                                 | L/U | 4    |
|     |                                                            |      | Statistikë                                                 | L/U | 2    |
| 4   | Bazat e ekonomise                                          | 6    | Mikro makro                                                | L   | 2    |
|     |                                                            |      | Administrim biznesi                                        | L/U | 4    |
| 5   | Fizikë e aplikuar                                          | 6    | Fizikë                                                     | L/U | 4    |
|     |                                                            |      | Termodinamike                                              | L/U | 2    |
| 6   | Kimi                                                       | 6    | Kimi inorganike                                            | L/U | 3    |
|     |                                                            |      | Kimi organike                                              | L/U | 3    |
| 7   | Biologji druri                                             | 6    | Biologji druri                                             | L   | 3    |
|     |                                                            |      | Biologji druri                                             | U   | 3    |
| 8   | Kimia e drurit dhe mbrojtja e drurit                       | 6    | Kimia e drurit                                             | L   | 2    |
|     |                                                            |      | Mbrojtja e drurit                                          | L/U | 4    |
| 9   | Politikat dhe Ligje                                        | 6    | Bazat e legjislacionit                                     | L   | 3    |
|     |                                                            |      | Politikat e legjislacionit në ID                           | L/S | 3    |
| 10  | Procese inxhinierike 1                                     | 6    | Mekanikë, Statikë                                          | L/U | 2    |
|     |                                                            |      | Teori Elem Makinash                                        | L/S | 4    |

#### Viti i Dytë - 60 ECTS

| No. | Module të detyrueshme  | ECTS | Lëndët         |     | ECTS |
|-----|------------------------|------|----------------|-----|------|
| 11  | Procese inxhinierike 2 | 6    | Vizatim teknik | L/U | 3    |

|    |                                           |   |                                              |     |   |
|----|-------------------------------------------|---|----------------------------------------------|-----|---|
|    |                                           |   | CAD 2D                                       | L/U | 3 |
| 12 | Struktura dhe fizika e materialeve        | 6 | Rezistenca e materialeve                     | L/U | 3 |
|    |                                           |   | Fizika e drurit                              | L/U | 3 |
| 13 | Teknologji druri 1                        | 6 | Makina e instrumenta prerës                  | L/U | 4 |
|    |                                           |   | Elektroteknike dhe bazat e kontrollit        | L/U | 2 |
| 14 | Bazat e projektimit të interierit         | 6 | Bazat e projektimit të interierit            | L   | 4 |
|    |                                           |   | Bazat e projektimit të interierit            | PJ  | 2 |
| 15 | Teknologji druri 2                        | 6 | Tharje druri                                 | L/U | 3 |
|    |                                           |   | Teknologjia e përpunimit mekanik të drurit   | PJ  | 3 |
| 16 | Përpunimi primar drurit                   | 6 | Lënde e sharruar                             | L/S | 3 |
|    |                                           |   | Panele me bazë druri                         | L/S | 3 |
| 17 | Prodhimi i mobiljeve                      | 6 | Hyrje në prodhimin e mobiljeve               | L   | 3 |
|    |                                           |   | Prodhimi i mobiljeve nga dizajni në realizim | U   | 3 |
| 18 | Tregjet e marketingu i produkteve drusore | 6 | Tregu i produkteve drusore                   | L   | 2 |
|    |                                           |   | Bazat e marketingut                          | L/S | 4 |
| 19 | Përpunimi sipërfaqësor i drurit           | 6 | Ngjitja e ilustrimi i drurit                 | L/S | 4 |
|    |                                           |   | Koncepte mbi cilesinë                        | L/S | 2 |
| 20 | Proceset e sistemet e punës               | 6 | Menaxhimi i proceseve të biznesit            | L/S | 3 |
|    |                                           |   | Ergonomi                                     | L/S | 3 |

### Viti i Tretë - 60 ECTS

|                                                |             |                                       |  |             |
|------------------------------------------------|-------------|---------------------------------------|--|-------------|
| <b>SPECIALIZIMI 1</b>                          | <b>ECTS</b> | <b>SPECIALIZIMI 1</b>                 |  | <b>ECTS</b> |
| Inxhnieri Teknologji Druri                     |             | Inxhnieri Teknologji Druri            |  |             |
| Module të detyrueshme të specializimit 18 ECTS |             | Lënde të detyrueshme të specializimit |  |             |

|                                             |                                                      |   |                                                      |     |   |
|---------------------------------------------|------------------------------------------------------|---|------------------------------------------------------|-----|---|
| 1                                           | Menaxhim prodhimi                                    | 6 | Projektimi i linjave                                 | L/U | 2 |
|                                             |                                                      |   | Transport i brendshëm                                | LS  | 2 |
|                                             |                                                      |   | Sistemet e aplikimit të biznesit                     | PJ  | 2 |
| 2                                           | Përpunim druri me CNC                                | 6 | Përpunim druri me CNC                                | LU  | 2 |
|                                             |                                                      |   | Përpunim druri me CNC                                | PJ  | 4 |
| 3                                           | Industri e drurit dhe inovacioni                     | 6 | Industri druri                                       | Esk | 4 |
|                                             |                                                      |   | Inovacion                                            | L   | 2 |
| Module me zgjedhje të specializimit 12 ECTS |                                                      |   | Lëndët me zgjedhje të specializimit                  |     |   |
| 1                                           | Njohuri Programimi                                   | 6 | Programming with Python basic (in Eng.)              | L/U | 3 |
|                                             |                                                      |   | Programming with Python adv. (in Eng.)               | L/U | 3 |
| 2                                           | Sisteme dixhitale ne proceset e perpunimit te drurit | 6 | CAD 2                                                | PJ  | 4 |
|                                             |                                                      |   | Sisteme dixhitale ne proceset e perpunimit te drurit | L/S | 2 |
| 3                                           | Bazat e bioekonomisë qarkulluese                     | 6 | Bazat e bioekonomisë qarkulluese                     | L   | 2 |
|                                             |                                                      |   | Aspekte teknologjike të ekonomisë qarkulluese në ID  | L/S | 2 |
|                                             |                                                      |   | Eskursion                                            | Eks | 2 |
| 4                                           | Përdorimi i drurit                                   | 6 | Dendrokronologji                                     | L/S | 3 |
|                                             |                                                      |   | Përdorimi i drurit                                   | L/E | 3 |
| 5                                           | Kontabilitet financiar                               | 6 | Financë kontabilitet                                 | L/U | 4 |
|                                             |                                                      |   | Modele optimizimi                                    | L/U | 2 |
| 6                                           | Gjuhë e huaj                                         |   | Gjuhë e huaj                                         | S   | 6 |

| SPECIALIZIMI 2                                 |                                         |   | SPECIALIZIMI 2                                      |                                    |   |      |
|------------------------------------------------|-----------------------------------------|---|-----------------------------------------------------|------------------------------------|---|------|
| Dizajni i mobiljeve dhe interierit             |                                         |   | ECTS                                                | Dizajni i mobiljeve dhe interierit |   | ECTS |
| Module të detyrueshme të specializimit 18 ECTS |                                         |   | Lëndë të detyrueshme të specializimit               |                                    |   |      |
| 1                                              | Dizajni i mobiljeve                     | 6 | Historia e mobiljeve                                | L                                  | 4 |      |
|                                                |                                         |   | Dizajni i mobiljeve                                 | PJ                                 | 2 |      |
| 2                                              | Kompozimi ne interior dizajn            | 6 | Kompozimi ne interior dizajn                        | L                                  | 3 |      |
|                                                |                                         |   | Kompozimi ne interior dizajn                        | PJ                                 | 3 |      |
| 3                                              | Studio Interior dizajn                  | 6 | Studio Interior dizajn                              | PJ                                 | 6 |      |
| Module me zgjedhje të specializimit 12 ECTS    |                                         |   | Lëndët me zgjedhje të specializimit                 |                                    |   |      |
| 1                                              | Dixhital dizajn                         | 6 | CAD 2                                               | PJ                                 | 3 |      |
|                                                |                                         |   | Dixhital dizajn (3dMax, )                           | PJ                                 | 3 |      |
| 2                                              | Vizatim i lire                          | 6 | Vizatim i lire                                      | L                                  | 2 |      |
|                                                |                                         |   | Vizatim i lire                                      | PJ                                 | 4 |      |
| 3                                              | Perpunimi i drurit me CNC dhe programim | 6 | Perpunimi i drurit me CNC                           | L/U                                | 3 |      |
|                                                |                                         |   | Programim 1                                         | L/U                                | 3 |      |
| 4                                              | Bazat e bioekonomise qarkulluese        | 6 | Bazat e bioekonomise qarkulluese                    | L                                  | 2 |      |
|                                                |                                         |   | Aspekte teknologjike te ekonomise qarkulluese ne ID | LS                                 | 2 |      |
|                                                |                                         |   | Excursion and Seminar                               | Esk                                | 2 |      |
| 5                                              | Gjuhe e huaj                            | 6 | Gjuhe e huaj                                        | S                                  | 6 |      |
| 6                                              | Kontabilitet financiar                  | 6 | Finance kontabilitet                                | L/U                                | 4 |      |
|                                                |                                         |   | Modele optimizimi                                   | L/U                                | 2 |      |